REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

Nr. 2886 prot

Maliq më 12/5/2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. 80, datë 12/05/2026

Për

"Miratimin e shpërblimit me honorar për angazhimin e një koreografi për ngritjen e Ansamblit të Valleve Popullore pranë Qendrës së Kulturës Multifunksionale "Dhimitër Orgocka", Maliq"

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", Neni 64 "*Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë*", gërma "c", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", Ligji Nr.10352, datë 18.11.2010 "*Për kulturën*", Udhëzim nr.4, datë 04.02.2025 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e Përgjithshëm nr.26, datë 08.09.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat*", si dhe në zbatim të buxhetit të miratuar të Bashkisë Maliq për vitin 2026, me qëllim zhvillimin e jetës kulturore dhe ngritjen e Ansamblit të Valleve Popullore, Këshillit të bashkisë i

PROPOZOJMË :

1. Të miratojë shpërblimin me honorare për angazhimin e një koreografi, me qëllim ngritjen, përgatitjen artistike dhe drejtimin koreografik të Ansamblit të Valleve Popullore pranë Qendrës së Kulturës Multi funksionale "*Dhimitër Orgocka*", Maliq.

2. Angazhimi i koreografit do të realizohet përmes kontratës së shërbimit artistik, për një periudhë **6 (gjashtë) mujore**, me fond **500,000 (*pesëqindmijë*) lekë**;

3. Shpërblimi do të bëhet çdo muaj sipas orëve që do të realizohen.

4. Paga orare do të jetë **6,944** (*gjashtëmijë e nëntëqind e dyzet e katër*) lekë /orë, për 12 orë në muaj.

5. Fondi për shpërblimin me honorar do të përballohet nga buxheti i miratuar i Bashkisë Maliq për **vitin buxhetor 2026**, programi "*Kulturë, art dhe trashëgimi kulturore*";

6. Të kryhen proçedurat ligjore për lidhjen e kontratës së shërbimit;

7. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike , Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit dhe shpalljes së tij sipas legjislacionit në fuqi.

Konceptoi: G.Floqi
N.Çaushi

12/05/2026
12/05/2026

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

Nr. 2886 prot datë 12/ 6 /2026

RELACION

Për

*"Projekt-vendimin "**Miratimin e shpërblimit me honorar për angazhimin e një koreografi për ngritjen e Ansamblit të Valleve Popullore pranë Qendrës së Kulturës Multifunksionale "Dhimitër Orgocka", Maliq**"*

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar Neni 64 "*Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë*", gërma "c", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", Ligji Nr.10352, datë 18.11.2010 "*Për kulturën*", Udhëzim nr.4, datë 04.02.2025 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e Përgjithshëm nr.26, datë 08.09.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat*", si dhe në zbatim të buxhetit të miratuar të Bashkisë Maliq për vitin 2026, me qëllim zhvillimin e jetës kulturore dhe ngritjen e Ansamblit të Valleve Popullore i kërkohet këshilit të bashkisë të miratojë;

Shpërblimin me honorare për angazhimin e një koreografi, me qëllim ngritjen, përgatitjen artistike dhe drejtimin koreografik të Ansamblit të Valleve Popullore pranë Qendrës së Kulturës Multifunksionale "*Dhimitër Orgocka*", Maliq.

Ky projekt-vendim ka për qëllim miratimin e shpërblimit me honorar për angazhimin e një koreografi profesionist, me synim ngritjen, organizimin dhe funksionimin e Ansamblit të Valleve Popullore pranë Qendrës së Kulturës Multifunksionale "*Dhimitër Orgocka*", Maliq.

Ngritja e ansamblit të valleve përbën një nevojë të rëndësishme për zhvillimin e jetës kulturore të qytetit, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore shpirtërore, si dhe përfshirjen active të të rinjve në aktivitete artistike dhe kulturore.

Angazhimi i koreografit do të realizohet përmes kontratës së shërbimit artistik, për një periudhë **6 (gjashtë) mujore**, dhe fond ii vendosur në dispozicion **500,000 (*pesëqindmijë*) lekë**;

Shpërblimi do të bëhet çdo muaj sipas orëve që do të realizohen.

Paga orare do të jetë **6,944** (*gjashtëmijë e nëntëqind e dyzet e katër*) lekë /orë, për 12 orë në muaj.

Fondi për shpërblimin me honorar do të përballohet nga buxheti i miratuar i Bashkisë Maliq për **vitin buxhetor 2026**, programi "*Kulturë, art dhe trashëgimi kulturore*";

Të kryhen proçedurat ligjore për lidhjen e kontratës së shërbimit;

Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike , Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit dhe shpalljes së tij sipas legjislacionit në fuqi.

Konceptoi: G.Floqi
N.Çaushi

_____/_____/2026
_____/_____/2026

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ